



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_.\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 148, datë 19.03.2024**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET E KËSHILLIT NR. 241, NR. 244, NR. 245 DATË 24.05.2023 DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 19.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Ridvan Hado, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtuëshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

**V Ë R E N**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 241, datë 24.05.2023 ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

2. Me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli), ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

3. Në vijim, me Vendimin nr. 245, datë 24.05.2023 Këshilli, ka vendosur:

*1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.*

4. Në këto procedura të ngritjes në detyrë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar deri më datë 14.06.2023. Kjo procedurë është shoqëruar me njoftimin përkatës dhe publikimin e vendimeve respektive të shpalljes së vendeve të lira dhe hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

6. Këshilli, me vendimin nr. 57 datë 07.02.2024, ka vendosur :

*1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

dhe pas shortit të hedhur

**2. Caktimin e relatorit si më poshtë:**

*.... Për kandidaten znj. {...} - z. Ridvan Hado.....*

7. Më datë 12.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua:

i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;  
ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;  
iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 19.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, është përcaktuar se: *“Për kandidaten, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidatja për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidatja duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidatja duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidatja duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

13. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të

vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

13.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 26.02.2024, përcolli në rrugë elektronike informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, informacioni u kërkua, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT**

### **14. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.**

15. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

16. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023.

17. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016, ndërkohë është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën nëntor 2015 – korrik 2016. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku vijon të ushtrojë funksionin.

18. Sipas informacionit të përcjellë në rrugë elektronike me datë 26.02.2024, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se: *“Kandidatja znj. {...}, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016. Me dekretin nr. 9326, datë 20.11.2015 të Presidentit të Republikës emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me vendimin nr. 13, datë 10.02.2017 të ish Këshillit të Lartë Drejtësisë caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe ushtron funksionin aktualisht. **Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 8 vite.** Znj.{...} nuk ka masa disiplinore në fuqi”.*

**19. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë.**

20. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë të paktën 5 vjet.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në rrugë elektronike me datë 29.02.2024, rezulton që kandidatja në vitin 2015 është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjyqtare dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional (1 vit), ku gjatë kësaj periudhe ka gjykuar të gjitha çështjet, si civile, familjare dhe penale.

21.1. Referuar të dhënave të mësipërme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kandidatja znj. {...}, për një periudhë 1 vjeçare, ka gjykuar *çështje të karakterit civil dhe penal.*

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, sipas urdhrave për ndarjen e gjyqtarëve në

dhomë/seksione dhe trupa gjykues për vitet 2017 e në vijim, rezulton se kandidatja ka gjykuar në seksionin civil dhe atë penal. Nga viti 2021 e në vijim gjykata nuk funksion e ndarë në seksione, e për rrjedhojë janë gjykuar të gjitha llojet e çështjeve nga trupa gjykuese.

22.1. Referuar të dhënave të mësipërme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kandidatja znj. {...}, për periudhën nga viti 2017 e në vijim, ka gjykuar *çështje të karakterit civil dhe penal*.

**23. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.**

**24. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.**

25. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

26. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

27. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

**28. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.**

**29. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.**

30. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë*

*ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efienca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

31. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 14.06.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

32. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.**

### **III. KONKLUZIONE**

34. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

35. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 8, në nenin 47, pika 4, në nenin 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar; si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 241, nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”; Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I :**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 241, nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023.



3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**